

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR KUALIFIKIMI PROFESIONAL “HOTELERI TURIZËM”

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6
Pikët						
Pyetja	7	8	9	10	11	12
Pikët						
Pyetja	13	14	15	16	17	18
Pikët						
Pyetja	19	20	21	22	23	24
Pikët						
Pyetja	25	26	27	28	29	30
Pikët						

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Në një hotel ka komunikim të drejtpërdrejtë me klientin, personeli i: **1 pikë**
- A) kuzhinës.
 - B) restorantit.
 - C) mirëmbajtjes.
 - D) administratës.
2. Cila nga karakteristikat e mëposhtme i përket hoteleve të vogla? **1 pikë**
- A) Kanë një kapital të madh investimi dhe financiar.
 - B) Drejtohen nëpërmjet një menaxheri të përgjithshëm.
 - C) Kanë një strukturë të burimeve njerëzore me drejtim vertikal.
 - D) Kanë një organizim kompleks të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore.
3. Hotelet me pronësi të drejtimit familjar janë hotelet: **1 pikë**
- A) shoqëri personash me ortakëri dhe emër të përbashkët.
 - B) zinxhirë hoteliere.
 - C) franchising.
 - D) biznes individual.
4. Pjesa e të ardhurës kombëtare që njerëzit e ndajnë për qëllime turistike quhet: **1 pikë**
- A) kërkesë turistike.
 - B) shpenzime turistike.
 - C) ofertë turistike.
 - D) konsum turistik.
5. Rritja e përgjithshme e ofertës monetare në një ekonomi të caktuar në një periudhë të caktuar quhet: **1 pikë**
- A) punësim.
 - B) inflacion.
 - C) deflacion.
 - D) rritje ekonomike.
6. Cili nga elementet e mëposhtme **NUK** është karakteristikë e ofertës turistike? **1 pikë**
- A) Elasticiteti.
 - B) Sezonaliteti.
 - C) Ngurtësia.
 - D) Kapaciteti mbajtës.
7. Personeli që **NUK** takohet me klientin është: **1 pikë**
- A) receptionisti.
 - B) shefi portenerisë.
 - C) shefi i kuzhinës.
 - D) shërbimet plotësues.
8. Dokumentacioni teknik që përdoret në ndërmarrjet hoteliere e gastronomike është: **1 pikë**
- A) fatura tatimore.
 - B) dokumentet e kontabilitetit.
 - C) vouchers.
 - D) të gjitha të mësipërmet.

9. Një klient në strukturën akomoduese nënshkruan faturën vetëm në momentin e regjistrimit chek in dhe largimit chek out, përdor metodën e pagesës: **1 pikë**
- A) me para në dorë (cash).
B) me chek personal.
C) me marrëveshje të drejtpërdrejtë.
D) me Kartë krediti.
10. Plotëso vendin bosh me alternativën e saktë:
..... është procesi i arritjes së objektivave organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera organizative. **1 pikë**
- A) Sipërmarrja.
B) Menaxhimi.
C) Marketingu.
D) Informimi.
11. Baza e aktiviteteve të marketingut është e përqendruar në katër elemente tradicionale, të njohura si 4 P-të e marketingut. Cili nga elementët e mëposhtëm nuk është pjesë e tyre? **1 pikë**
- A) Produkti.
B) Vendi.
C) Promocioni.
D) Plani.
12. Sa do të jetë kosto e mallrave të shitur në barin e hotelit, në qoftë se gjendja fillestare e mallrave në fillim të muajit ishte po njësoj sa gjendja përfundimtare, si dhe blerjet gjatë muajit ishin 100.000 lekë? **1 pikë**
- A) 50.000 lekë.
B) 100.000 lekë.
C) 150.000 lekë.
D) 200.000 lekë.
13. Bazuar në rregullat e funksionimit të llogarive, cili nga veprimet e mëposhtme **NUK** regjistrohet në debi? **1 pikë**
- A) Pakësimi i një aktivi.
B) Pakësimi i një detyrimi.
C) Pakësimi i kapitalit të pronarit.
D) Pakësimi i të ardhurave.
14. Paga minimale aktuale në Republikën e Shqipërisë është: **1 pikë**
- A) 35 000 lekë.
B) 50.000 lekë.
C) 45 000 lekë.
D) 40.000 lekë.
15. Bankat e nivelit të dytë **Nuk** ofrojnë: **1 pikë**
- A) ruajtjen e normës së interesit.
B) hapjen e llogarisë rrjedhëse të biznesit.
C) dhënie e kredisë.
D) transfertat bankare.

- 16. Etika e biznesit Global bazohet në:** **1 pikë**
- A) kodin i Punës.
 B) legjisllacionin e një vendi.
 C) konventat ndërkombëtare.
 D) procedurat tatimore.
- 17. Llogaria shërben për:** **1 pikë**
- A) regjistrimin kronologjik të veprimeve ekonomike.
 B) regjistrimin e të gjitha veprimeve ekonomike me natyrë homogjene.
 C) regjistrimin e efekteve të veprimeve ekonomike.
 D) regjistrimin e dokumenteve kontabël.
- 18. Plotësoni shprehjen me frazën e duhur. _____ jep informacion mbi atë çfarë ka ndodhur gjatë vitit në ndërmarrje.** **1 pikë**
- A) Bilanci Kontabël.
 B) Bilanci Vërtetues.
 C) Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.
 D) Pasqyra e Kapitalit të pronarit.
- 19. Kostot të cilat mund t'i ngarkohen në mënyrë të qartë një qendre kostoje quhen:** **1 pikë**
- A) Kosto fikse.
 B) Kosto variable.
 C) Kosto direkte.
 D) Kosto indirekte.
- 20. Cila alternativë shpreh saktë ndërhyrjen e qeverisë në ekonominë e një vendi:** **1 pikë**
- A) Ka rënë rëndësia e sektorit publik.
 B) Shpenzimet qeveritare nuk ndikojnë në sektorin privat.
 C) Shpenzimet qeveritare në të gjitha nivelet kanë qenë në rritje.
 D) Taksat dhe shpenzimet qeveritare kanë ndikim të vogël në ekonomi.
- 21. Listoni 5 (pesë) kritere themelore ku bazohet klasifikimi i strukturave hoteliere:** **5 pikë**
- 1) _____
 2) _____
 3) _____
 4) _____
 5) _____
- 22. Listoni 4 (katër) dokumente që përdoren në sektorin e kuzhinës:** **4 pikë**
- 1) _____
 2) _____
 3) _____
 4) _____

23. Rolet Marketing më të rëndësishme në një ndërmarrje turistike janë:

6 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____
- 5) _____
- 6) _____

24. Renditni 3 (tre) lloje Aktive Afatgjata Materiale.

3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

25. Një biznesmen D.T. vendos të fillojë një aktivitet shitjeje. Ai investon në shoqëri 2.800.000 lekë si investim kapitali, duke i vendosur paratë në llogarinë rrjedhëse bankare. Fillimisht ai blen një njësi shitjeje (**Ndërtesë**) 1.500.000 lekë dhe truallin (**Toka**) që i kushtoi 800.000 lekë.

Kërkohe:

3 pikë

- 1) Të regjistrohet në ditari krijimi i aktivitetit.
- 2) Të regjistrohet në ditari blerja e ndërtesës dhe e truallit.
- 3) Të regjistrohet në llogari në formë T-je veprimet e mësipërme.

26. Cilët janë 4 (katër) nga faktorët që përcaktojnë kërkesën?

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

27. Rendit 5 (pesë) nga detyrat e shefit të portenerisë:

5 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____
- 5) _____

28.Renditni 4 (katër) nga format ligjore të regjistrimit të biznesit:

4 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

29.Evidentoni 3 (tre) veçori ku qëndron marrëdhënia midis turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm:

3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

30.Cilët janë 3 (tre) elemente kryesore përbërëse të ofertës turistike?

3 pikë

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____

